



THIRRJE PËR KOORDINATOR LOKAL - PROJEKTI “TË RINJ AKTIVË PËR DEMOKRACI QYTETARE 2”

Titulli: Koordinator Lokal

Vendndodhja: Patos, Shqipëri

Fillimi i kontratës : 13.10.2023

Përfundimi i kontratës: 30.06.2024

Përshkrimi

Situata aktuale në Shqipëri, pavarësisht përmirësimeve, vazhdon të tregojë një diferencë të konsiderueshme për sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve, grave dhe komuniteteve të marginalizuara në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit. Shkaku kryesor i kësaj mangësie varion nga pabarazia gjinore tek mungesa e kapaciteteve dhe programeve të institucioneve për t'u ofruar brezave informacion të saktë mbi procesin e vendimmarrjes dhe demokracinë qytetare. Në këtë situatë, iniciativat e arsimit joformal paraqesin mundësi shtesë për të përmbushur nevojat e komuniteteve të marginalizuara, për të promovuar angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Duke marrë parasysh situatën e sipërpërmendur, Qendra po zbaton projektin "Të rinj aktivë për demokraci qytetare 2", në Bashkinë Patos. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të nxisë dhe promovojë angazhimin qytetar të të rinjve përmes pjesëmarrjes në vendimmarrjen lokale.

Objektivat

Qendra Europiane është duke kërkuar një Koordinator Lokal i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e Forumit Tematik Rinor Patos në bashkëpunim me Bashkinë Patos.

Detyrat dhe përgjegjësitë

Më konkretisht, detyrat dhe përgjegjësitë e kërkuara nga Koordinatori Lokal janë si më poshtë:

- Të koordinojë Forumin Tematik Rinor Patos;
- Të mbajë komunikimet mes Qendrës dhe Forumit dhe e anasjellta;
- Të organizojë të paktën 1 takim në muaj me Forumin;
- Të përgatisë minutat e takimit, fotot të aktiviteteve të anëtarëve të Forumit;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e anëtarëve të Forumit në trajnime, takime, angazhime në kuadër të projektit;
- Të sigurojë zbatimin e iniciativave të forumit;
- Të raportojë në bazë të rregullt tek Qendra Europiane.

Kriteret e nevojshme:



- Diplomë e ciklit të parë bachelor, preferohet në Shkenca Sociale, Marrëdhënie me Publikun, Drejtësi, Menaxhim, Mësuesi;
- Rezidente në Bashkinë Patos;
- Të ketë njohuri të përgjithshme për sfidat e komunitetit apo të rinjve, të fituara nga trajnime të ndryshme, praktika apo eksperiencia pune.
- Eksperiencë pune të mëparshme me të rinjtë
- Aftësi shumë të mira komunikimi;
- E aftë të punojë me mbikëqyrje minimale;
- Eksperience e mëparshme pune me të rinjtë, aktivizmin ose me organizata të shoqërisë civile;

Të gjithë të interesuarit janë të lutur të dërgojnë CV- në e tyre dhe letër motivimi deri në datën 10 tetor 2023 në adresën e emailit europcentrefoundation@gmail.com ose nëpërmjet postës në adresën rruga Vaso Pasha, Pl. 20/57, Tiranë, Shqipëri.